

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2025/2026

(java e katërt, deri më 25.01.2026)


TË DHËNA JAVORE

Gjatë javës së katërt të vitit 2026 (nga 19.01-25.01.2026) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 1.708 ($I=93,0/100.000$) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 17,2% më pak se javën që shkoi (2.062).

Në javën e katërt të vitit të kaluar janë regjistruar 1.878 të sëmurë (rënie për 9,1%), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (2.566) është regjistruar një rënie prej 33,4%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit ($I=22,03/100.000$) gjatë javës së katërt është mbi kufirin javor për aktivitet mesatar $I=90,84/100.000$.

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2025, sezoni 2024/2025 dhe sezoni 2025/2026




Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 1.029 të sëmurë, ndërsa tek grupmosha mbi 65 vjet – 253, tek grupmosha 5-14 vjet - 243 dhe tek grupmosha 0-4 vjet – 183 të sëmurë.

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në 28 QSHP/NJR, pra në Shkup – 526, Strumicë - 178, Ohër – 113, Kumanovë – 102, Tetovë – 84, Shtip – 78, Kavadar – 77, Dibër – 75, Manastir - 55, Gjevgjeli – 54, Veles – 42, Radovish – 32, Sveti Nikole – 59, Gostivar – 52, Negotinë – 30, ndërsa në qytetet e tjera numri i të sëmurëve është nën 30.

Në 2 QSHP/NJR është regjistruar aktivitet shumë i lartë i virusit të gripit, në 3 aktivitet i lartë, në 9 aktivitet mesatar, në 12 njësi aktivitet sezonal, ndërsa në 2 është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit.

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit dhe incidenca në 100.000 banorë, java katërt, 2026



Gjatë javës së katërt të raportimit të vitit 2026 nuk janë raportuar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së katërt të raportimit pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 85 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Nga materialet e testuara 15 kanë rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit - 8 Influenza A(H3), 6 Influenza A(H1)pdm09, si dhe 1 rast Influenza A e pasubtipizuar.

Nuk është regjistruar rast pozitiv me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar edhe 5 raste pozitive me RSV.

MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - TË DHËNA KUMULATIVE


Gjatë sezonit 2025/2026 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin është **9.917** (I=539,9/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n= 5.698) numri i rasteve të raportuara është rritur për 74,0%, ndërsa krahasuar me modelin për 15 vitet e fundit (n= 9.622) është regjistruar një rritje prej 3,1%.

Të sëmurë janë regjistruar në të gjitha QShP/NjR. Numri më i madh i të sëmurëve (n=2.662) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (I=1.709,2/100.000) në Dibër (n=327).

Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numri më i madh i të sëmurëve bëjnë pjesë në grupmoshën që përfshin numrin më të madh të popullatës (nga 15-64 vjet) – 5.841 raste (58,9%), ndërsa incidencë më e lartë (806,7/100.000) është regjistruar tek grupmosha 5-14 vjet.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal sipas QSH/MJR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2025/2026



Shpërndarja e rasteve sipas muajve:

- tetor – 338 raste ose 3,4%
- nëntor – 438 raste ose 4,4%
- dhjetor – 1.324 raste ose 13,4%
- janar – 7.817 raste ose 78,8%

Deri më tani janë regjistruar 3 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE – TË DHËNA KUMULATIVE

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 681 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARL për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Janë zbuluar 99 raste pozitive të gripit:

o Influenza A – 99 Influenza


- A(H1)pdm09 – 26 (26,3%)
- Influenza A(H3) – 60 (60,6%)
- Influenza A – e pasubtipizuar – 13 (13,1%)

- Influenza B – 0

Janë regjistruar 6 rezultate pozitive për SARS-CoV-2 dhe 31 pozitive për RSV.

Janë detektuar edhe 5 viruse të tjerë respiratorë tek mostrat e testuara.

Grafiku 2. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes të mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja rutinore dhe sentinel, RMV, 2025/2026



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vazhdon rënia e numrit dhe incidencës të sëmundjeve të ngjashme me gripin në nivel javor, numri i rasteve të raportuara . Gjatë javës së katërt është regjistruar aktivitet mesatar i virusit të gripit në vendin tonë. Rezultatet e fituara nga mbikëqyrja virologjike tregojnë se ka një përhapje rajonale të virusit të gripit. Përqindja e rasteve pozitive për katër javë me radhë është mbi 10%.

Sipas të dhënave të pranura në Maqedoni ka një intensitet të lartë të virusit të gripit.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi: <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtje nga gripi kanë për qëllim parandalimin e të gjitha sëmundjeve akute të frymëmarrjes dhe mund të jenë shumë të dobishme, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Evitoni grumbullimin dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, sidomos kontaktin e ngushtë me njerëz që janë të sëmurë ose që kolliten, teshtijnë, kanë temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose me dezinfektues.

- Ngrohni dhomat në të cilat qëndroni dhe ajrosini ato shpesh.
- Këshillohet të vishni rroba të ngrohta, në disa shtresa, të bëni banjo të ngrohta.
- Pini pije të nxehta (çajra dhe supa), lëngje frutash, ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira e të nevojshme për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limona, portokalle) janë veçanërisht të dobishme. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë të disponueshme, mund të përdoren edhe pije dhe preparate multivitaminike.
- Praktikoni një stil jetese dhe zakone të shëndetshme, duke përfshirë këtu gjumin dhe pushimin e mirë, të ushqyerit e shëndetshëm, ruajtjen e aktivitetit fizik dhe mendor dhe uljen e stresit.

Sistemi i fortë imunologjik do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose ta përballoni më lehtë gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht të shëndetshëm dhe keni një sistem imunologjik të fortë, prapëseprapë mund të sëmureni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?

Ndiqni këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë ose në vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë ndërsa jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një pecetë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidhni ato në plehra.
- Mbani maskë mbrojtëse kur kontaktoni me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagta që përmbajnë alkool ose dezinfektues për pastrimin e duarve.
- Shmangni prekje të syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën ku qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbajeni mjedisin tuaj të pastër - objekte, sipërfaqe, me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjet ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkon ndihmë mjekësore.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritete të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 77.263 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vaksina falas.**

- ❖ 2.400 vaksina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vaksina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.836 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 79.099 persona me vaksina falas dhe vaksina komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e tretë të vitit 2026:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute (ARI) është rritur mbi nivelet bazë në 24 nga 31 vendet rajonit evropian të OBSH-së që raportojnë.
- Aktiviteti i gripit në nivel rajonal tregon shenja të rënies në shumë vende, por mbetet i lartë dhe i shpërndarë gjerësisht.
- Personat mbi 65 vjet vazhdojnë të përfaqësojnë numrin më të madh të personave të hospitalizuar si pasojë e gripit.
- Gripi i tipit A (H3) mbetet virusi mbizotërues në qarkullim, por përqindja e rasteve me A(H1) ngadalë po rritet.
- Indikatorët rajonalë të aktivitetit të SARS-CoV-2 kanë rënë dhe janë në nivel bazik.
- Përqindja e raste e pozitive me RSV është rritur tek pacientët e mbrojtjes shëndetësore primare, por stabil në spitalet sentinel. Fëmijët në moshë nën 5 vjet vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të rasteve.

***Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik***